

**Raport për rezultatet e konsultimeve publike
Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor**

1. Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Konsultimi nëpërmjet regjistrimit elektronik të njoftimit dhe konsultimit public (RENJK) ka zgjatur 20 ditë pune, sikurse kërkohet nga ligji, nga data 12.02.2024 deri më 11.03.2024 si dhe në datën 28.03.2024 është zhvilluar mbledhja e Bordit të Informacionit Gjeohapësinor (BIG), ku mes anëtarëve u diskutuan dispozitat e projektligjit.

3. Metoda e konsultimit

Konsultimet për projektligjin janë zhvilluar nëpërmjet regjistrimit elektronik të konsultimeve publike dhe marrjes së komenteve në mbledhjen e parashikuar të Bordit për Informacionin Gjeohapësinor (BIG). Gjithashtu, janë në vënë në dispozicion kanalet e komunikimit zyrtar të ASIG për shkëmbimin e informacionit: faqe Web e ASIG: <https://www.asiq.gov.al/> dhe adresa e E-mail-it të ASIG: info@asiq.gov.al.

4. Palët e interesit të përfshira

Ky konsultim ka targetuar qytetarë, ekspertë të fushës së gjeoinformacionit, nga të gjitha institucionet dhe subjektet e interesuara, organizata jofitimprurëse, shoqëria civile, të drejtat ose objekti i veprimtarisë të cilave ka të bëjë apo ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo nga përcaktimet e kësaj nisme ligjore.

Institucioni nuk ka zhvilluar takime publike.

Më datë 28.03.2024 është zhvilluar mbledhja e anëtarëve të Bordit të Informacionit Gjeohapësinor.

1. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Nuk është marrë feedback nga publikimi i projektligjit në RENJK apo kanalet e tjera të komunikimit (e-konsultim) të vëna në dispozicion për target grupet e synuara.

Nga mbledhja e anëtarëve të BIG, zhvilluar më datë 28.03.2024, është arritur marrja e komenteve dhe mendimeve mbi nisën ligjore.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/I pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
<ul style="list-style-type: none">Korrigjimi i ndryshimit të varësisë së ASIG nga ish-Ministri i Inovacionit dhe Administratës Publike tashmë tek Kryeministri	<i>Situatë de facto që duhej ndryshuar në përmbajtjen e tekstit të ligjit.</i>	Anëtarët e BIG	Anëtarët u dakortësuan mbi ndryshimet dhe shtesat e	Çështjet e adresuara në projektligj janë të nevojshme diktuar nga situata e sektorit të informacionit gjeohapësinor

<ul style="list-style-type: none"> • Pozicionimi i qartë i ASIG përkundrejt institucioneve të tjera të sektorit, roli i tij qendror, koordinues dhe monitorues, si dhe arkitektura e re organizimit të funksioneve në këtë institucion • Shtesa dhe ndryshime për të arritur përputhshmërinë e plotë me Direktivën Inspire si dhe ligjin “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, miratuar në përputhje me Direktivën për të dhënat e hapura. 			propozuara në projektligj.	si dhe situatë de facto në ASIG.
--	--	--	----------------------------	----------------------------------